



|  |            |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO |            |
| KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN     |            |
| 01 Nr. / Br.                           | 173/23     |
| Nr. i sq. / Br. nt                     | - 8 -      |
| Data: / Datum                          | 12.07.2023 |
| VUSHTRRI - VUČITRN                     |            |



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN**

### **PROCESVERBAL**

**në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 11:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Maxhuni, Agron Perçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia, (anëtarë të KPF-së).

*Gjithashu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova (Nënkyetar i Komunës), drejtori i drejtive, Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore, Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar, Xhavit Mehmeti, kryesues i komisionit për hartimin e Draft - Planit Komunal për Integritet, si dhe Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se zërimi në sallën e kuvendit nuk është duke funksionuar si duhet, ku mikrofonët e një pjesë të madhe të anëtarëve kuvendit nuk janë duke punuar. Qysh kam informacione, bëhet fjalë për një defekt të vogël, por nuk është duke u trajtuar ky problem nga askush. Prandaj, është në përgjegjësinë e juaj si kryesuese të krijoni kushte të punës për kuvendin. Kërkoj nga ana e juaj që të merreni me këtë problem dhe që për seancën tjetër të vihet në funksion zërimi.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – ju njoftojë se unë i kam kryer të gjitha procedurat dhe nuk jam larguar asnijëherë nga përgjegjësia. Kemi menduar se është një problem i vogël, por sipas zyrtarit të IT-së nuk bëhet fjalë për një problem të vogël. Ne e kemi proceduar përsëri kërkesën, presim që të kryhet ky problem.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – po e paraqes një shqetësim të banorëve në rrugën “Drenica”, përkatësisht lagja “Kosumi” që lidhet me Begaj, të cilët janë pa ujë të pijes që dy ditë. Si pasojë e reshjeve të shumtë të shiut, puset (bunaret) janë të pasfrytëzuara, për shkak të ujit të turbullt. Prandaj, komuna të interesohet dhe të merr informacione nga kompania “Ujësjellësi” se ku është problemi dhe të njoftohen banorët për këtë. Meqenëse jemi në këtë situatë të jashtëzakonshme, si pasojë e vërvshimeve, ai kërkoi që pjesë e komisionit për vlerësim të dëmeve të jenë edhe anëtarët e kuvendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – propozoi që të futet në rend të ditës dhe të procedohet për kuvend <Shqyrtimi i Raportit lidhur me gjendjen momentale nga vërvshimet në Komunën e Vushtrrisë dhe mundësia e përkrahjes financiare>.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se gjendja në qytet është e rënduar, e sidomos kjo pjesa te rruga “Lidhja e Lezhës”. Prandaj, komisioni të del në terren dhe ta hartojë një raport, si dhe të bëhet vlerësimi i dëmeve. Kam informacione që qytetarëve ju kanë thënë

bëni fotografi dhe na i dërgoni, pastaj komisioni del në terren. Prandaj, duhet të solidarizohemi me qytetarët që janë prekur nga vërvshimet, tha ajo.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike (anëtar i shtabit emergjent)** – tha se komisioni për vlerësimin e dëmeve eshtë formuar dje nga Kryetari i Komunës, i cili nuk eshtë vetëm nga zyrtarët e komunës, por edhe nga profesionistë jashtë komunës. Ne iu kemi thënë qytetarëve që së bashku me kërkesën, të bashkëngjiten edhe dëshmi (fotografi), pastaj komisioni del e bën evidentimin e dëmeve dhe pastaj bëhet kompensimi.

**Dardan Abazi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike (anëtar i shtabit emergjent)** – deklaroit se objekti i gjimnazit ka qenë i gatshëm nëse do të kishte nevojë për strehim të familjeve. Ai tha se gjatë periudhës së vërvshimeve, kemi qëndruar deri në orët e vona duke e përcjellë situatën.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – theksoi se faqja zyrtare e komunës të jetë më aktive dhe të freskohet me informata në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar për gjendjen, sepse informatën për objektin e gjimnazit që ka qenë i gatshëm, ka mundësi që shumë qytetarë nuk e kanë ditur.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:*

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.5.2023;
  2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2024-2026 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë;
  3. Shqyrtimi i Draft – Planit Komunal për Integritet 2023 – 2025;
  4. Shqyrtimi i Draft – Planit komunal për riintegrin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023 – 2025;
  5. Shqyrtimi i Petpcionit lidhur me rrugën “Eesly Clark”;
  6. Shqyrtimi i Petpcionit lidhur me ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 82/23, të datës 30.03.2023;
  7. Shqyrtimi i kërkesës për financimin e botimit të librit “Rrezet e Lirisë – Dëshmoriët e Kombit të Zonës së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës;
  8. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Burgosurve Politikë;
  9. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, për periudhën janar – qershor 2023;
  10. Shqyrtimi i Raportit lidhur me gjendjen momentale nga vërvshimet në Komunën e Vushtrrisë dhe mundësia e përkrahjes financiare;
  11. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.5.2023.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – theksoi se në procesverbal mos të nxirret vetëm konteksti i fjalisë, por komplet diskutimi.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15.5.2023.*

- Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2024-2026 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se duhet të bëhet një fushatë informuese për organizimin e dëgjimeve buxhetore, në mënyrë që të njoftohen qytetarët, sepse po kemi pjesëmarrje të ultë të qytetarëve dhe në disa raste po dështojnë edhe takimet se nuk po ka fare pjesëmarrës. Prandaj, buxheti duhet të hartohet në bazë të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

Lidhur me kalendarin, ai propozoi që ashtu qysh kemi qenë vitin e kaluar ne si anëtarë të KPF-së, edhe këtë vit të jemi ashtu.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se në këto takime duhet të jenë të pranishëm edhe nga qeveria komunale, sepse po ka kërkesa specifike nga qytetarët dhe ne nuk po kemi mundësi t’iu japim përgjigje, sepse po jemi të pa informuar.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se pasi që KPF-ja është bartëse e procesit të dëgjimeve buxhetore, atëherë kalendarin duhet ta plotësojmë sot, duke përfshirë emrat e anëtarëve të KPF-së, datat e mbajtjes së takimeve. Po ashtu, në çdo takim duhet të ketë procesmbajtës nga ekzekutivi komunal.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – u shpreh se datat ndoshta është më mirë që t’i përgatit Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kurse në kuvend plotësohet kalendarët edhe me anëtarë të kuvendit.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që datat e takimeve le të caktohen nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kurse emrat e anëtarëve të KPF-së (kryesues të takimeve) të mbeten ata qysh kanë qenë vitin e kaluar dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

- Shqyrtimi i Draft – Planit Komunal për Integritet 2023 – 2025.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – deklaroi se as rregulloret e as planet e kuvendit nuk e kanë vlerën e vet nëse bëhen vetëm për marketing. Edhe ky plan mendoj se po bëhet vetëm për marketing dhe nuk ka ndonjë efekt veprimi në fusha të caktuara. Në rastin konkret, i përgëzoj hartuesit e këtij plani, sepse është një plan i hartuar mirë dhe se komisioni është profesional.

Ai pyeti se çfarë efekti pozitiv mund të ketë ky plan në praktikë? Cilat do të jenë beneficiet për komunën?

**Xhavit Mehmeti, kryesues i komisionit për hartimin e Draft – Planit Komunal për Integritet 2023 – 2025** – tha se këtu jam për ta pasqyruar punën e komisionit dhe se me ato që i the pajtohem plotësisht. Është hera e tretë që ky plan aprovohet nga kuvendi, kurse në praktikë ka pak rezultate. Nuk është një plan që është shpikje e jona, por është një model unik në të gjitha komunitatet, e sidomos pjesa e parë. Kurse, në brendi të planit gjenden specifikat e secilës komunë, në këtë rast ne si komision i kemi futur në plan specifikat që i ka komuna jonë. Pas miratimit, duhet të ndërrmen veprimi për implementimin e tij nga Kryetari i Komunës që është menaxher i këtij plani, i cili do ta caktojë koordinatorin që do të merret me këtë çështje. Komuna e Vushtrrisë ka marrë mirën johje kët vit për hartimin e këtij plani vitin në vitin e kaluar.

Ky plan është një preventivë, në mënyrë që të ndërmerren hapa për t'u përmirësuar. Se a ka benefit komuna, konsideroj se ka benefite, sepse në kuadër të vlerësimit të performancës ka tregues që lidhen me këtë plan dhe merr vlerësim pozitiv nëse është i aprovuar dhe se komunat që kanë performancë të lartë fitojnë edhe grante.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i Draft – Planit komunal për riintegrin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023 – 2025.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se edhe ky është rast i njëjtë si plani tjetër, prandaj nuk dua të diskutojë, por do ta procedojmë dhe përkrahim. Por, është mirë të gjenden mekanizma impletues.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se pajtohem me Ilmiun, se njëjtë po ndodhë edhe me komisionet e themeluara nga kuvendi për hartimin e rregulloreve, sepse po kopjohen nga komunat tjera dhe po has në vështirësi implementimi i tyre. Njëjtë ka ndodhë me rregulloren për themelim të komiteteve që unë kam votuar kundër dhe e kemi kundërshtuar dhe po shpresoj që do të kontestohet nga MAPL-ja.

Lidhur me këtë plan, ne si komunë nuk kemi implikime buxhetore, por qeveria e ka obligim që të merret me implementimin e tij me mjete buxhetore.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me rrugën “Wesly Clark”.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – theksoi se kërkesa e qytetarëve ka ardhë pa u aprovuar vendimi në kuvend, por ka ardhur me vonesë. Prandaj, jemi që ta procedojmë në kuvend.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – kam informacione që ky peticion ka ardhur para seancës së fundit që e kemi mbajtur në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe në Kuvend. Nuk po ju akuzoj që nuk e keni proceduar, sepse ka ardhë vonë, atë ditë që është mbajtur seanca. Por, kam edhe kërkesa të qytetarëve që po kërkojnë të hapet rruga nga “Selacët” te spitali e deri te “Interexi”.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – siç po e shihni në material, tek ne ka ardhur më 31 maj (ditën e seancës).

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – lidhur me këtë pikë, kisha pasur dëshirë të jetë i pranishëm Kryetari i Komunës që ta diskutojmë këtë situatë. Ne si grup kuvendar edhe atë ditë kur është votuar në kuvend i kemi pasur rezervat tona dhe sa më kujtohet edhe nuk e kemi mbështetur. Kjo ka qenë edhe arsyja, sepse ne kemi biseduar me qytetarët, ku na i kanë paraqitur shqetësimet e tyre lidhur me këto vendime. Sa e ka ndryshuar gjendjen ky vendim lidhur me organizimin e komunikacionit në Komunën e Vushtrrisë para dhe pas këtij vendimi? Sipas meje, nuk ka ndryshuar asgjë, vetëm se është krikuar më shumë tollovi. Ai tha se vendimet merren me e zbut kaosin, me zbrit frekuencën e qarkullimit dhe me gjet zgjidhje alternative. Nga ajo që kemi parë deri më sot, nuk është që ka pasur ndonjë

ndikim pozitiv, por përkundrazi në disa pjesë, e sidomos pjesa kah spitali ka pasur ankesa, sharje, buri të veturave dhe ankesa të shumta nga bizneset që po ndihen se janë të dëmtuar. Ai tha se duhet të bëhen matje para se të merret vendimi. E jo të eksperimentohet pas marrjes së vendimit nga kuvendi. Prandaj, këtë petition do ta shqyrtojmë në kuvend dhe shpresojmë që kryetari apo dikush nga stafi i tij të na jep përgjigje se cili ka qenë efekti i këtij vendimi.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – zbatimi i pjesërishëm i vendimit nuk është në kompetencë as të kryetarit, as drejtorit e as ndonjë zyrtari. Zbatimi i kuvendit të komunës duhet të bëhet në tërësi. Sa kam informacione, Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë matje para marrjes së vendimit. Prandaj, interes i përgjithshëm është mbi interesat e ndonjë biznesi apo individi. Sipas meje, është bërë zgjidhje e duhur me ndërrimin e kahjeve të lëvizjes, po flas për pjesën ku jetoj se qarkullimi është lehtësuar tejmase. E përgëzoj kryetarin dhe drejtorinë për këtë vendim, por e kritikoj për zbatim të pjesërishëm të tij. Para një kohe janë bërë shumë bllokada te “Interex” dhe është dashur të ndërrmerret diçka në këtë drejtim. Pastaj, rrathi te “Ura e Gurit” ka qenë çdoherë i bllokuar dhe ka qenë i influencuar nga të gjitha anët, ku pasur raste që është bllokuar deri në një orë. Por, tash nuk ka pritje te ky rreth.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – ka pasur disa seanca që e kam ngritur shqetësimin lidhur me shkarkimin e mallrave te udhëkryqi afër “Interex” dhe te “Viva fresh Store”, ku fatkeqësisht edhe tani po bllokohet nga ana e kamionëve të mëdhenj.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike** – afër udhëkryqit te “Interex”, ekziston shenja për orarin e shkarkimit të mallrave. Ndërkakq lidhur me rrugët njëkahëshe, ai tha se i kemi pasur dy takime me biznese dhe me ta jemi dakorduar që rruga “Galip Badivuku” veç mos të mbyllët, se për që bëhet rrugë njëkahëshe nuk e kemi problem. Ai tha se drejtoria ka bërë matje një javë ditë, ku kanë qenë të vendosura disa shenja të përkohshme.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se ta procedojmë në kuvend që ta shqyrtojmë dhe t'i japim kahje këtij petitioni.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Petitionit lidhur me ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 82/23, të datës 30.03.2023.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Shqyrtimi i kërkesës për financimin e botimit të librit “Rrezet e Lirisë – Dëshmorët e Kombit të Zonës së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se kjo kërkesë për përkrahje financiare është e arsyetuar mirë dhe besoj që si kuvend do ta përkrahim. Prandaj, ai propozoi që të procedohet për kuvend.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – lidhur me këtë kërkesë, e çmojmë punën që ka bërë autor i librit për angazhimin e tij, zbardhjen e historisë, ruajtjen e kujtesës historike të

ngjarjeve të luftës së fundit, por edhe më herët në bazë të përmbajtjes që e ka paraqitur në këtë botim. Jemi që ta përkrahim këtë kërkesë, por po krijohet një praktikë jo e mirë, sepse nuk është në kompetencën e kuvendit. Prandaj, askush nuk do të votonte kundër kësaj përkrahje financiare për botim të këtij libri, por në anën tjetër të gjithë po e dimë se po veprojmë kundërligjshëm, sepse me rregullore nuk parashihet kjo formë e financimit apo ndarjes së subvacioneve. Prandaj, shpresoj që do të jetë kjo kërkesa e fundit që na vjen në kuvend.

Lidhur me botimin e librave, sa kam informacione Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e ka një kod të veçantë buxhetor, të cilin e planifikon. Nëse ka buxhet në atë fond, le ta mbështet drejtoria dhe ne mund vetëm të votojmë si fuqizim të arsyetimit të drejtorisë për ndarjen e mjeteve financiare. Nëse nuk ka mjete të mjaftueshme në Drejtorenë për Kulturë, Rini dhe Sport, atëherë mund të merren mjete nga Drejtoria për Arsim apo edhe nga drejtore të tjera, e jo të ndahen mjete nga kuvendi.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – kjo kërkesë ka ardhë edhe vitin e kaluar dhe me shkresë përcjellëse e kam proceduar në Drejtorenë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe nuk kam informacione se çfarë përgjigje i është kthyer palës. Por, e kam kërkesë nga pala që të procedohet në kuvend. Prandaj, kam vendosur ta procedoj në KPF dhe bashkërisht mund ta procedojmë në kuvend.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – e mirëkuptoj Sylejmanin dhe nuk është hera e parë që na kanë ardhur kërkesa dhe kështu ka qenë praktikë. Por, rastet specifike kanë gjetur mirëkuptim dhe alternativa për përkrahje. Në rastin konkret, autori në mënyrë të thuktë na e ka dërguar një material përmbajtësor, në pikë të shkurta që thotë shumë dhe duhet të gjejmë alternativë për ta përkrahur. Siç shihet nga kërkesa, autori ka punuar shumë në hartimin e këtij libri, por edhe veprimtaria patriotike, humane, ushtarake, kontributi i gjithanshëm është i pamohueshëm. Kështu që, kjo është vetëm një pjesë e vogël e borxhit dhe obligimi tonë që mund t'ua kthejmë intelektualëve dhe njerëzve të tillë. Prandaj, ta procedojmë në kuvend dhe ta përkrahim kërkesën në fjalë.

**Medina Bunjaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – tha se këtë kërkesë e kemi pranuar edhe në vitin e kaluar për përkrahje në vlerë 8100 euro. Por, fondi i drejtorisë në tërësi për botimin e librave është 6000 euro dhe është fond i vogël për ta përkrahur. Palën e kemi sugjeruar që të aplikon në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, ku është thirrrja e hapur për këtë çështje dhe mundësi më të mëdha financiare për përkrahje.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – deklaroi se si kuvend komunal i kemi të ndara përgjegjësitë nga Qeveria e Kosovës. Prandaj, në bazë të bindjeve tonë do të marrim vendim meritор për këtë kërkesë. Me vendim do ta caktojmë mënyrën e përkrahjes dhe implementimin e vendimit, tha ai.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – nuk do të kemi asnjë dilemë që titujt dhe hulumtimet si ky libër meritojnë mbështetje dhe vlerësim maksimal. Atë që e tha drejtoresha e kulturës, po shihet se mungon vizioni. Pasi që tha se kjo kërkesë ka qenë edhe vitin e kaluar, atëherë është dashur që sivjet të planifikohet më shumë buxhet në fondin për botimin e librave. Ai tha se duhet të shikohet që nga kategoria “Mallra dhe shërbime” a ekziston mundësia për botimin e librave dhe të lidhet kontrata për ofrimin e shërbimeve.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

## 8. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Burgosurve Politikë.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – theksoi se e ka sjellë në KPF që bashkërisht të vendosin se ku ta procedojnë më tutje.**

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se kjo shoqatë ka pasur ankesa nga fillimi kur janë bërë ndarjet e subvencioneve. Dilemë është se nëse e dërgojmë në kuvend, a mos po krijojmë praktika të tillë edhe për të ardhmen. Në anën tjetër, mos me procedu në kuvend është çështje e ndjeshme, sepse shoqatat e luftës dhe kjo shoqatë janë kategori e ndjeshme. Nuk është kryetari i pranishëm në mbledhje, sepse nuk e kishim proceduar fare në kuvend, por kryetari e ka mundësinë ta përkrah në vlerë deri 1000 euro.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së** – me gjithë respektin për të gjitha shoqatat dhe me dëshirën për t'i përkrahur, edhe unë mendoj që duhet ta adresojmë në drejtorinë përkatëse ose te kryetari.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se kjo shoqatë ka bërë kërkesë për rishqyrtimin e ndarjes së subvencioneve dhe se ne nuk e kemi këtë kompetencë. Por, është një komision i ankesave, i cili i shqyrton ankesat për ata që janë të pakënaqur.

Me Ilmiun nuk pajtohem që mos ta procedojmë në kuvend, për shkak se po krijojmë standarde të dyfishta, sepse kërkesa paraprake u procedua në kuvend. Prandaj, të procedohet në kuvend dhe kryetari pastaj vendos sipas mundësive buxhetore.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) vota “për” dhe tri (3) “kundër”, një (1) “abstenum” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

## 9. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, për periudhën janar – qershor 2023.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – theksoi se jemi në mes të qershorit dhe informata po flet për periudhën janar – qershor 2023. Prandaj, e kam këtë vërejtje në titullin e informatës, sepse përndryshe e përgëzoj drejtoreshën është një informatë e mirë dhe i ka sjellë çdoherë informatat.

**Hava Mlinaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-** tha se do ta ndryshojmë titullin e informatës, por në vitin e ardhshëm këtë informatë do ta zhvendosim në muajin korrik.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se e përgëzon drejtoreshën për punën dhe angazhimin dhe për këtë informatë. Prandaj, ju bëj thirrje edhe drejtorive tjera që ta përcjellin planin e punës dhe me kohë të na i sjellin materialet.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

10. Shqyrtimi i Raportit lidhur me gjendjen momentale nga vërshimet në Komunën e Vushtrrisë dhe mundësia e përkrahjes financiare.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

11. Të ndryshme.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se që nga muaji shkurt pagesat për anëtarët e KPF-së nuk janë kryer. Prandaj, kemi shkuar në sekretarinë e kuvendit për t'u informuar lidhur me këtë çështje, ku kemi has në vështirësi për komunikim. Prandaj, e kemi kuptuar që nuk janë proceduar në ministri pagesat edhe pse na është thënë që i kemi dërguar. Kam bërë shkresë zyrtare edhe në sekretari, por edhe te ti si kryesuese e kuvendit dhe kam kërkuar se pse nuk po bëhet kompensimi i mëditjeve për KPF. Por, ende nuk kam marrë përgjigje. Prandaj, kërkoj një përgjigje zyrtare lidhur me këtë çështje.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se ka shumë paqartësi lidhur me kompensimin e mëditjeve. Kemi pasur 2-3 takime me kryesuesit e kuvendeve të komunave ku kemi diskutuar dhe ka laramani nëpër komuna. Ka komuna që i kanë proceduar mëditjet për komitetet obligative por nuk ju kanë dalë mjetet. Por, ka komuna që nuk i kanë proceduar me kërkesë të ministrisë derisa të rregullohet çështja. Si kolegjum i kryesuesve jemi pajtuar që t'i procedojmë mëditjet e komiteteve obligative dhe që nga ky muaj i kemi proceduar dhe a i pranon ministria apo jo është çështje e tyre. Pastaj, nëse ekzekutohen mjetet, atëherë do të procedohen në mënyrë retroaktive, po ashtu kush ka marrë mjetë më shumë do t'iu bëhet ndalesa.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – iu kisha sugjeruar që të kërkoni opinion ligjor edhe nga ministria, por edhe nga zyra ligjore e komunës lidhur me këtë çështje.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – përgjigjen zyrtare do ta merrni brenda afatit ligjor.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Bujar Klinaku

B. Klinaku  
Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

M. Basholli  
Kryesuese e KK-së dhe KPF-së